

## **Florian Ballhysa**

### **Komisioner Publik**

Z. Florian Ballhysa u lind në Tiranë, në vitin 1978. Kreu studimet e tij universitare pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës, ku u diplomua në vitin 2001. Në vitin 2008, z. Ballhysa fitoi titullin “Master në Studime Evropiane” nga Universiteti i Tiranës.

Eksperienca profesionale e z. Florian Ballhysa përfshin angazhimet e tij si avokat, këshilltar ligjor dhe konsulent i pavarur. Ai ka punuar për shumë vite në Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën e Lartë, Kuvendin e Shqipërisë, si dhe në projekte të financuara nga organizata ndërkombëtare. Prej vitit 1999, z. Florian Ballhysa ka qenë pjesë aktive e shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarit të asamblesë, anëtarit të bordit dhe së fundmi kryetar i Asamblesë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Me vendimin nr. 82/2017, të Kuvendit të Shqipërisë, z. Florian Ballhysa u zgjodh Komisioner Publik.